



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 476 Prot.

Durrës më, 18/3 / 2022

VENDIM

Nr 16 , datë 18.3.2022

PËR

**"MIRATIMIN E TARIFËS SË APLIKIMIT DHE TARIFËS SË REGJISTRIMIT, PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË DOKTORATË NË SHKENCA
EKONOMIKE, PRANË FAKULTETIT TË BIZNESIT NË UNIVERSITETIN
"ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 3 "Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë", pika 3/ç ku citohet se: "Autonomia financiare garantohej nëpërmjet së drejtës për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj", Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, vendimit të Senatit Akademik nr.32, datë 16.04.2021, vendimit të Bordit të Administrimit nr.21, datë 27.04.2021, Urdhërit të MAS nr. 134, datë 17.03.2022, vendimit të Senatit Akademik nr.14, datë 18.03.2022, Bordi Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën e aplikimit dhe tarifën e regjistrimit, për studentët të cilët regjistrohen për herë të parë, në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "Shkenca Ekonomike", pranë Fakultetit të Biznesit, në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Tarifa e aplikimit për kandidatët të cilët do të aplikojnë për herë të parë në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë, do të jetë 3000 (tre mijë) lekë.
3. Tarifa e regjistrimit të kandidatëve fitues të cilët do të regjistrohen për herë të parë në programin e studimit të ciklit të tretë Doktoratë do të jetë 5000 (pesë mijë) lekë.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtorja e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

